

1



**DORACAK PËR HETIME KRIMINALISTIKE
DHE MBIKËQYRJE INSPEKTUESE NË RAST
E HELMIMIT TË KAFSHËVE TË EGRA**



**BALKAN
DETOXLIFE**



BalkanDetox LIFE (LIFE GIE/NL/001016)

Dëshirojmë të falënderojmë:

prof. dr. Marina Malish Sazdovska (Fakulteti i Sigurisë – Shkup), Darko Blinkov (Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor), prof. dr. Valentina Stamenković-Sllavevska (Instituti i Biologjisë - Fakulteti i Shkencave Natyrore-Matematikore), Goran Mlladenovski (Njësia për ekzaminim ligjor – Ministria e Punëve të Brendshme), dr. Metodija Veleviski (Shoqata ekologjike maqedonase), Bojan Tërpeski (Shoqata maqedonase e avokatëve të rinj), Zoran Vuiq (Inspektorati shtetëror i pylltarisë dhe gjuetisë), Akademia për Krim kundër Kafshëve të Egra – Junta de Andalucia, Ljupka Radinska (Agjencia për Ushqim dhe Veterinari), prof. dr. Tërpe Ristoski (Fakulteti i Mjekësisë Veterinare), Marko Naumovski, Katerina Dimevska, Vančo Novosellski (Agjencia për Ushqim dhe Veterinari), Bazhe Dimitriovski (Ministria e Punëve të Brendshme), Janko Stojanovski (Ministria e Punëve të Brendshme)

Doracaku për hetime kriminalistike dhe inspektimin e rasteve të helmimit të kafshëve të egra në Republikën e Maqedonisë së Veriut u përgatit në kuadër të projektit rajonal BalkanDetox LIFE (LIFE19 GIE/NL/001016) i cili do të zbatohet deri në vitin 2025 dhe synon të përforcojë kapacitetet kombëtare në luftën kundër helmimit të kafshëve të egra. Projekti financohet nga Programi LIFE i Bashkimit Evropian, ku Fondacioni për mbrojtjen e shkabave (VCF) është koordinatori kryesor ndërsa Shoqata ekologjike maqedonase ka rolin e koordinatorit kombëtar. Qëllimi i këtij doracaku është të lehtësojë punën e institucioneve kompetente shtetërore që preken në rastet e helmimit të kafshëve të egra në Maqedoninë e Veriut gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre.

Doracak për hetime kriminalistike dhe mbikëqyrje inspektuese në rast e helmimit të kafshëve të egra

Прирачник за криминалистички истраги и инспекциски надзор при случаи на труење диви животни

Autori i fotografisë së kopertinës: Hristo Peshev, Bullgari

Autori i fotografisë së pasme: Shoqata ekologjike maqedonase

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2025

Autore: Arta Starova (Shoqata ekologjike maqedonase)

Redaktorë: Arta Starova

Përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhën shqip: Vjosa Taipi

Lektore: Jordana Shemko Georgievska

Lektor në gjuhën maqedonase: Dejan Vasilevski

Botues: Shoqata ekologjike maqedonase

Dizajni dhe botimi: Kontura

Tirazhi: 200




Përmbajtja

Parathënie	4
Hyrje	6
Korniza ligjore	7
Masat parandaluese	10
Buri met e njohurive	11
Hetimi kriminalistik	12
Hetimi ne vendin e ngjarjes	13
Gjurmet dhe mostrat	15
Procedurat e pergjithshme per marrjen e mostrave	17
Identifikimi i nje kafshe te helmuar	18
Percaktimi i dates se vdekjes dhe aplikimi i entomologjise mjeko-ligjore	21
Karrem helmues	22
Analiza e hollesishme e karremave me helm	23
Funksionet dhe procedurat e laboratorit mjeko-ligjor	24
Hetimi	25
Referenca	26

**“Një njeri që vret një kafshë sot,
nesër do të vrasë gjithashtu
edhe dikë që do ta
kundërshtojë.”**

– Diane Fossey



Parathënie

E themeluar në vitin 1972, Shoqata Ekologjike e Maqedonisë (SHEM) është një nga organizatat më të vjetra joqeveritare për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila punon me këmbëngulje për mbrojtjen e biodiversitetit të pasur të vendit dhe për promovimin e harmonisë midis njerëzve dhe natyrës. Nëpërmjet disa dekadash angazhim, organizata u bë avokuesi kryesor për jetën e egër, ekosistemet dhe një të ardhme të qëndrueshme. Aktivitetet e SHEM-it për mbrojtjen e shpendëve në Maqedoni filluan me zbatimin e Programit për ruajtjen e grabitqarëve në vitin 2002. Grabitqarët luajnë një rol të pazëvendësueshëm si “pastruues të natyrës”, duke parandaluar shpërhapjen e sëmundjeve dhe duke e ruajtur ekuilibrin delikat të ekosistemeve. Sidoqoftë, ata tani janë ndër speciet më të rrezikuara në rajon, duke u përballuar me kërcënimin e tyre më të madh – karremat helmues që vendosen për kafshët e egra.

SHEM e kuptoi se luftimi i helmimit të kafshëve të egra nuk do të thotë vetëm shpëtimi i grabitqarëve, por edhe mbrojtje e ekosistemeve të tëra dhe siguri i një mjedisi më të shëndetshëm dhe më të sigurt për të gjitha speciet, duke përfshirë njerëzit. Në kuadër të projektit BalkanDetox LIFE (LIFE19 GIE/NL/001016), SHEM-i i udhëhoqi përpjekjet kombëtare për të trajtuar këtë krim kompleks dhe shpesh të neglizhuar mjedisor. Duke organizuar punëtori të specializuara për prokurorët publikë, nëpunësit policorë, veterinerët zyrtarë, inspektorët mjedisorë dhe inspektorët e gjuetisë, organizata ndihmoi në ndërtimin e bazave për përgjigje më të fuqishme dhe më efektive institucionale ndaj rasteve të helmimit të kafshëve të egra. Këto përpjekje kulminuan me sukses të madh: Inspektorati Shtetëror për Mjedisin Jetësor miratoi zyrtarisht një Procedurë standarde operative (PSO) për trajtimin e rasteve të helmimit të kafshëve të egra, duke siguruar një protokoll të qartë dhe uniform për trajtimin e rasteve të helmimit.

Për të përforcuar më tej institucionet, SHEM-i, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH), luajti një rol të madh në krijimin e Grupit kombëtar të punës për luftë kundër helmimit të kafshëve të egra, i cili është zyrtarizuar nga MMJPH-ja dhe i



bashkon institucionet kryesore dhe ekspertët e përkushtuar për zgjidhjen e këtij problemi në vend. Po vazhdon përgatitja dhe miratimi i Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër helmimit të kafshëve të egra në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke hapur kështu rrugën për një zgjidhje të koordinuar dhe të qëndrueshme të kësaj çështjeje kritike në vend. Puna e SHEM-it lidhet gjithashtu ngushtë me iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare, duke u frymëzuar nga praktikat kryesore kundër helmimit në Spanjë. Në kuadër të BalkanDetox LIFE, SHEM mori pjesë në mënyrë aktive në Akademinë Spanjolle për Krimin mbi Kafshët e Egra, duke fituar përvojë dhe duke kontribuar në rrjetin evropian në rritje, kushtuar luftës kundër krimit ndaj kafshëve të egra.

Në vitin 2025, regjistrimi i kryer nga anëtarët e Shoqërisë Ekologjike të Maqedonisë dhe Shoqatës për Ruajtjen e Natyrës “Akvila” nga Kavadari konfirmoi praninë e 19-20 çifteve të shpendëve grifonë këtë sezon folezimi – 9 prej tyre në koloninë në Grykën e Demir Kapisë, dhe 10-11 në koloninë në Liqenin e Tikveshit. Për herë të fundit kemi pasur një numër të tillë në vitin 2010 ndërsa incidentet e shpeshta me helmim në Ballkan shkaktuan uljen e popullsisë së tyre në vetëm 6 çifte në vitin 2018.

Duke zbatuar këto aktivitete në vitet e fundit, SHEM-i jo vetëm që punon drejt përmirësimit të mbrojtjes së grabitqarëve, por e përforcon gjithashtu kapacitetin kombëtar për luftë kundër krimit mjedisor, duke inkurajuar një të ardhme më të drejtë dhe biologjikisht të larmishme për të gjithë.

Është thelbësore që të gjithë qytetarët të marrin pjesë në raportimin e rasteve të helmimit të kafshëve shtëpiake dhe të egra.

Lufta është e përbashkët dhe përpjekja duhet të jetë kolektive për ta zgjidhur përfundimisht këtë vepër penale. Përveç rritjes së ndërgjegjësimit, qëllimi i këtij doracaku është që t'u shërbejë institucioneve kryesore (nëpunësve policorë dhe organeve të inspektimit) për të vepruar në mënyrë efektive kur përballohen me raste të helmimit të kafshëve të egra.

Hyrje

Karremat helmues janë ndër shkaqet kryesore të vdekjes së panatyrshme të shumë specieve të rrezikuara, pasi ato janë një mjet jo selektiv për vrasjen e kafshëve, veçanërisht specieve mishngrënëse dhe kërmë ngrënëse, të cilat, për shkak të dietës së tyre, janë më të ekspozuara ndaj helmimit. Karremat me helm janë metoda më e përdorur për shfarosjen e grabitqarëve në zonat rurale në të gjithë botën (Márquez, et al. 2012) dhe përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për biodiversitetin. Shumë zogj grabitqarë mishngrënës në Maqedoninë e Veriut janë shfarosur ose popullsia e tyre është zvogëluar në mënyrë drastike për shkak të karremave helmuese. Një nga efektet shkatërruese të këtyre karremave është se kafsha e helmuar mund të shkaktojë vdekje masive ose zhdukje lokale të një specije të caktuar.

Për një kohë të gjatë, përdorimi i paligjshëm i karremave me helm për të shfarosur dëmtuesit, përkatësisht speciet që shkaktojnë konflikte me njerëzit për shkak të dëmtimit të të korrave dhe bagëtive (Howard, 1962), ka qenë një praktikë e vendosur në shumë pjesë rurale të Evropës (Graham et al. 2005).

Lloji i helmimit	Prioritet	Palët e interesit	Qëllimi kryesor
Karrema me helm për kontrollin e grabitqarëve	I lartë	Blegtorë; gjuetarë	Konfliktet midis njeriut dhe kafshëve të egra – grabitqarët
Karrema me helm për të kontrolluar qentë endacakë	I mesëm	Komunitetet lokale; blegtorë; gjuetarë	Kontrolli i kafshëve – kryesisht qen endacakë
Helmimi për shkak të kontrollit të kafshëve (rodenticidet)	I lartë	Komunitetet lokale; fermerët	Kontrolli i "insekteve" për të zvogëluar dëmin mbi kulturat
Helmimi për të parandaluar dëmet te bletarët	I mesëm	Komunitetet lokale; bletarët	Konfliktet midis njeriut dhe kafshëve të egra – grabitqarët
Karrema me helm për të zgjidhur mosmarrëveshjet e ndërsjella	I lartë	Komunitetet lokale	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të ndërsjella

Tabela 1. Llojet e helmimit në vend dhe rishikim i palëve të interesuara

Korniza ligjore

Legjislacioni nacional

Baza për mbrojtjen e natyrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 52/91; Amendamentet I-II). Kushtetuta përcakton të drejtën për një mjedis jetësor të shëndetshëm (neni 43, paragrafi 1), ndërsa burimet natyrore të vendit, jeta bimore dhe shtazore përcaktohen si të mira me interes të përgjithshëm që kanë mbrojtje të veçantë (neni 56, pika 1). Për më tepër, çdo qytetar ka për detyrë të promovojë dhe mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën (neni 43, paragrafi 2).

Mbrojtja e natyrës dhe kafshëve përpunohet më tej nga disa ligje, ndërsa helmimi i kafshëve të egra mund të vendoset në kategorinë e akteve të ekzekutimit në disa vepra penale të përcaktuara nga Kodi penal. Më poshtë janë listuar zgjidhjet ligjore nga legjislacioni kombëtar që konsiderohen më të rëndësishmet, kur bëhet fjalë për helmimin e paligjshëm të kafshëve të egra ose përdorimin e karremave me helm:

Ligji për kafshët e egra dhe gjuetinë:

Neni 60 përcakton se është e ndaluar gjuetia e kafshëve të egra në mënyrë dhe me mjete me të cilat kafshët e egra shkatërrohen masivisht, përfshirë edhe me helm.

Ligji për mbrojtjen e natyrës:

Neni 43 ndalon përdorimin e mjeteve joselektive për kapjen ose gjuajtjen e specieve të mbrojtura të kafshëve të egra, si dhe mjeteve që mund të shkaktojnë zhdukje lokale ose shqetësim serioz të popullatave të atyre specieve, në përputhje me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, kurse në veçanti helmet dhe mjetet dehëse, si dhe karremat helmues dhe dehës.

Ligji për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve:

Neni 4 paragrafi 6 i këtij ligji ndalon shkaktimin e dhimbjeve, vuajtjeve ose lëndimeve, sjelljen mizore dhe çnjerëzore dhe vrasjen e kafshëve në kundërshtim me dispozitat e ligjit.

Ligji për fitofarmaci:

Megjithëse ky ligj nuk adreson në mënyrë specifike helmimin e kafshëve të egra, ai është i rëndësishëm sepse rregullon përdorimin e substancave helmuese në bujqësi. Përdorimi i pamjaftueshëm i produkteve të tilla fitosanitare është një shkak i zakonshëm i helmimit të paqëllimshëm të kafshëve të ndryshme të egra.

Ligji për pastërtinë publike:

Në raste të caktuara, kërkohet bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror komunal ose me shërbimet komunale lokale sepse largimi i një kafshe të helmuar mund të shkaktojë helmim sekondar, ose kufoma mund të jetë burim i sëmundjeve të mëtejshme. Në këtë ligj parashikohet se ndalohet lënia e kafshëve të ngordhura dhe shpendëve, sepse në të kundërt cenohet pastërtia publike e vendeve të hapura dhe ndërtesave publike.

Kodi penal

Neni 218-b Ekocidi përcakton se "një person i cili, në kundërshtim me ligjin, me qëllim dëmtimin e mjedisit, do të ndërmarrë një veprim ose nuk do të ndërmarrë një veprim i cili do të rezultojë në dëmtim të rëndë ose të përhapur gjerësisht ose do të shkaktojë dëm afatgjatë mbi mjedisin jetësor, dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm." Një karrem me helm i vendosur në natyrë mund të rezultojë me helmim masiv i cili mund të përhapet gjerësisht, nëse disa kafshë, pas konsumimit, migrojnë në një zonë tjetër.

Neni 228 ndalon gjuetinë në mënyrën ose mjetet me të cilat kafshët e egra shfarosen masivisht..

Neni 230 ndalon personat të mbledhin, të hedhin ose të lënë mbetje të rrezikshme që përmbajnë shpërthim, reaktivitet, ndezshmëri, irritim, toksicitet, infektivitet, kancerogjenitet, mutagjenitet, teratogjenitet, ekotoksicitet ose veti të shkarkimit të gazit toksik nëpërmjet reaksionit kimik dhe dekompozimit biologjik.

Neni 232-a i referohet "ai që vret, shkatërron, mban ose merr ekzemplare të specieve të mbrojtura të florës ose faunës së egër".

Neni 233 ndalon një person të "vrasë kafshë pa arsye të justifikueshme, ose ta keqtrajtojë rëndë, ose ta ekspozojë ndaj torturave të panevojshme, ose të shkaktojë dhimbje të panevojshme, ose, për hir të një përvoje, ta ekspozojë ndaj vuajtjes."

Neni 288 ndalon që një person, me anë të zjarrit, përmbytjes, shpërthimit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës motorike, energjisë elektrike ose energjisë tjetër, ose me ndonjë veprim ose agjent tjetër të rrezikshëm të përgjithshëm, të shkaktojë një rrezik të konsiderueshëm për jetën ose trupin e personave, ose për pronën në përmasa të mëdha.

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Marrëveshjet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe BE Direktivat në lidhje me helmimin e paligjshëm të kafshëve të egra të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut:



Konventa për mbrojtjen e specieve migruese të kafshëve të egra (Bon, 1979)

Kjo konventë është e rëndësishme për luftën kundër helmimit të kafshëve të egra. Konventa thekson rreziqet që vijnë nga përdorimi i mjeteve joselektive për të kapur ose vrarë speciet e egra, si dhe mjetet që mund të shkaktojnë zhdukje lokale ose shqetësim serioz për popullatat e atyre specieve.



Konventa për mbrojtjen e jetës së egër dhe habitateve natyrore në Evropë (Bern, 1979)

Shtojca IV vëren se përdorimi i helmeve dhe karremave helmues dhe dehës për vrasjen, kapjen dhe forma të tjera të shfrytëzimit të kafshëve të egra është i ndaluar.



Direktiva për shpendët (Direktiva 2009/147/EC)

Direktiva për shpendët (Direktiva 2009/147/EC), neni 8 paragrafi 1 ndalon përdorimin e çdo mjeti ose metode të përdorur për kapjen ose vrasjen në masë ose jo selektive të shpendëve, ose që mund të shkaktojë zhdukjen lokale të specieve, në veçanti metodat e listuara në Aneksin IV (a), në të cilat "karremat helmuese" përfshihen në mënyrë specifike si një mjet i ndaluar.



Direktiva 2024/1203 ose Direktiva për krimin mjedisor

Kjo direktivë zëvendësoi konventën e mëparshme të vitit 2008 dhe është dokumenti kryesor ligjor i BE-së për luftë kundër krimit mjedisor. Direktiva, ndër të tjera: 1) përcakton terma të shumëfishtë, duke përfshirë "paligjshmërinë"; 2) sugjeron se cilat sjellje duhet të kriminalizohen, cilat duhet të konsiderohen si forma kualifikuese, rrethana rënduese, etj.;

3) ofron udhëzime mbi elementet me të cilat vlerësohet nëse dëmi është i konsiderueshëm, duke përfshirë elementet me të cilat vlerësohet nëse një sjellje do të shkaktojë dëme në ajër ose tokë, cilësinë ose statusin e ujërave, ekosistemeve, kafshëve ose bimëve; 4) për cilat sjelljet duhet të ndëshkohen nxitja, ndihma dhe mbështetja; 5) parashikon sanksione për personat fizikë dhe juridikë; 6) detyron shtetet anëtare të sigurojnë personelin e nevojshëm, burimet financiare, teknike dhe teknologjike që autoritetet kompetente të jenë në gjendje të kryejnë në mënyrë efektive funksionin e tyre; 7) detyron shtetet anëtare të mbledhin statistika për veprat e kryera penale në pajtim me Direktivën; 8) detyron shtetet anëtare të përgatisin strategji kombëtare për luftë kundër krimit mjedisor dhe përditësimin e tyre të paktën çdo 5 vjet.

Masat parandaluese

Policia, shërbimet e inspektimit, koncesionerët e gjuetisë, gjuetarët, rojet dhe shërbimet pyjore mund të veprojnë në mënyrë parandaluese duke krijuar një sistem masash, kontrollesh dhe aktiviteteve për mbrojtjen e natyrës. Informacioni i shpejtë, i saktë dhe i plotë në lidhje me krimin mjedisor, siç është helmimi dhe pasojat e tij, mund të parandalojë një ngjarje të tillë në një zonë specifike (Sazdovska, 2013).

Parandalimi arrihet nëpërmjet metodave të mëposhtme:

- **Kontrollet e rregullta**
(veçanërisht në vendet e shënuara si pika të mundshme të helmimit);
- **Informimi i publikut** për helmimin e paligjshëm dhe pasojat e tij;
- **Bashkëpunimi dhe dhënia e ndihmës profesionale** në veprime të përbashkëta me autoritetet e tjera kompetente.



Burimet e njohurive

Kur një palë e tretë raporton një incident të mundshëm të helmimit të një kafshe të egër, nëpunësi policor kompetent ka për detyrë të mbledhë informacion në lidhje me rastin, në mënyrë që të informojë prokurorin publik kompetent (PP) dhe kështu të hapë një procedurë parahetimore dhe hetimore. Informacionet që mbledhen më pas mund të çojnë në zbulimin, sigurimin dhe ndihmën për dokumentimin e gjurmëve të helmimit. Përgjegjës për mbledhjen e këtij informacioni fillestar janë policia, si dhe shërbimet përkatëse të inspektimit (inspektori shtetëror për mbrojtjen e natyrës, veterineri zyrtar pranë AUV, inspektori shtetëror për gjueti). Në kuadër të bashkëpunimit, policia duhet të ketë një rol vendimtar në të gjitha fazat e veprimit operacional (Sazdovska, 2013).

Ekzistojnë burime të ndryshme të informatave fillestare

Denoncime nga
qytetarët

Organet
inspektuese

Mjetet për
informim publik

Vetëraportim

Raport anonim/
pseudonim

Zbatimin e një
metode treguese

Raportime nga
persona juridikë

Gjatë zbardhjes së
rasteve të veçanta

Vëzhgim i menjëhershëm

Raportim nga një nëpunës i
strukturave të sigurisë;

Të kapur në flagrancë
(in flagranti)

Sipas thashethemeve

Pasi të konfirmohet besueshmëria e këtyre informacioneve dhe e burimeve të tyre, fillon **hetimi kriminalistik**.


Hetimi kriminalistik

Kur kryejmë hetim kriminalistik të veprave penale mjedisore, siç është helmimi i kafshëve të egra, **koha është kundër nesh**. Substancat helmuese të përdorura janë të ekspozuara ndaj kushteve të motit dhe ato mund të çojnë në degradimin e tyre. Për shkak të degradimit, mund të mos zbulohen në analizat laboratorike.



Për më tepër, këto substanca janë **vdekjeprurëse** dhe të **rrezikshme** dhe, nëse nuk trajtohen në mënyrë të sigurt, mund të çojnë në pasoja katastrofike. Prandaj, në raste të tilla, personat e kualifikuar duhet të veprojnë shpejt, me efikasitet, por edhe me kujdes.

Gjithashtu, në rastet e helmimit të kafshëve të egra, rrallë ka dëshmitarë dhe është e vështirë të përcaktohet se karremi i helmuar ishte vendosur aty ku është gjetur kafsha e ngordhur. Këtu në lojë janë faktorë të tjerë, si për shembull, për çfarë pesticidi bëhet fjalë, sa prej tij konsumoi kafsha dhe nëse ishte e uritur para se të konsumonte karremin, nëse është një kafshë që udhëton në distanca më të gjata (si zogjtë), etj. Prandaj, është e nevojshme që policia dhe shërbimet e inspektimit të jenë këmbëngulëse dhe të sakta në përpunimin e të dhënave.



Pasi të konfirmohet dyshimi për helmimin e një kafshe të egër, vendi i ngjarjes sigurohet dhe të gjithë palët e interesuara përfshihen për të pasur një hetim cilësor dhe gjithëpërfshirës të incidentit.

Hetimi në vendin e ngjarjes

Me urdhër të Prokurorit Publik, hetimi në vendngjarje kryhet nga grupi i inspektimit. Policia gjyqësore, me autorizim nga prokurori publik, mund të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme të zbulimit pa urdhër paraprak nga prokurori publik, por detyrimisht duhet ta informojë për masat e ndërmarra (Kallaxhiev et al., 2018). Grupi i inspektimit përbëhet nga një inspektor (zakonisht është një inspektor i përgjithshëm i krimit) dhe teknikë kriminalistik. Një pjesë e grupit të inspektimit zhvillon biseda me dëshmitarë dhe/ose të dyshuar. Inspektorët kontrollojnë identitetin e personave të lidhur me incidentin.



Nëse nuk ka dëshmitarë të pranishëm, zhvillohen biseda informuese me persona pranë ngjarjes. Pjesa tjetër e grupit të inspektimit (teknikë kriminalistik) përqendrohet në vendngjarje dhe përgatit procesverbalin, dokumentacionin fotografik dhe mbledh/siguron mostra (gjurmë, dokumentacion, karrem helmues, viktimë).



Gjatë hetimit, inspektori duhet t'u përgjigjet **“nëntë pyetjeve të arta”** të mëposhtme në kriminalistikë (Sazdovska, 2013):

1. Çfarë ka ndodhur?
2. Kur ka ndodhur?
3. Ku ka ndodhur?
4. Si është kryer?
5. Me çfarë është kryer?
6. Me kë është kryer?
7. Pse është kryer?
8. Kush është autori?
9. Kush ose çfarë... (është sulmuar)?



Veterineri zyrtar i AUV-së mund të thërrasë një mjek të mjekësisë veterinarë nga shoqëria më e afërt veterinarë (ambulanca/klinika) për të marrë pjesë në konfirmimin ose refuzimin e dyshimit për helmim dhe konfirmimin e dyshimit për një sëmundje ngjitëse dhe, si dhe në mbledhjen dhe paketimin e kufomës ose pjesëve të kufomës nga kafsha e ngordhur. Për më tepër, rekomandohet komunikimi me Fakultetin e Mjekësisë Veterinarë për të marrë kufomën ose pjesët e kafshës së ngordhur për ekzaminim të shenjave të helmimit ose sëmundjes ngjitëse. Nëse dyshohet për helmim, kërkesa për analizë toksikologjike paraqitet nga një prokuror publik ose nga punonjësit e policisë.

Parimi i shkëmbimit sipas Locard bazohet në idenë se dhunuesi lë elementet (gjurmët) e veta në vendngjarje, por nëpërmjet shkëmbimit merr me vete disa nga elementet e mjedisit. Me përjashtim të karremave dhe viktimave, është e nevojshme të mbliidhen të gjitha mostrat nga vendi i helmimit, pavarësisht nëse janë të lidhura me rastin.

Në përgjithësi, mostrat që do të mbliidhen ndahen në 2 lloje:

Ekzemplarë biologjikë (me origjinë njerëzore, shtazore ose bimore)

- Pendë, flokë, lesh;
- Plehu (mund të zbulojë helmim e konsumuar);
Lëngjet e trupit;
- Gjak;
- Kufoma;
- Insektet.

Mostra të tjera

- Toka (nën trupin/karremin, polen, plehra, minerale);
- Sende (qese, bishta cigareshe, copa letre, kuti plastike, copa pëlhure) që do të shërbenin për të mbledhur gjurmë të mundshme të origjinës biologjike ose shkaktim të gjurmëve të linjave papilare;
- Gjurmë nga automjet;
- Gjurmët e këmbëve.

Mostrave duhet t'u bashkëngjiten gjithmonë procesverbalet përkatëse. Këto procesverbale duhet të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm të lëndës (materialit, ngjyrës, formës, etj.), të shoqëruara me fotografi dhe një përshkrim të vendndodhjes ku janë gjetur. Gjatë analizimit të vendit të ngjarjes mbahet procesverbal i hollësishëm i asaj që është gjetur dhe ku është gjetur. Rekomandohet që së pari të bëhet një ekzaminim i plotë vizual (në pjesën statike), dhe më pas të fillojë mbledhja e provave materiale (në pjesën dinamike). Në rast helmimi, të gjithë karremat dhe e gjithë viktima mbliidhet nga vendi i incidentit për të parandaluar helmimin e mëtejshëm të kafshëve të tjera. Për të shmangur përkeqësimin e cilësisë së mostrave të mbledhura në rast të helmimit të dyshuar, është shumë e rëndësishme që mostrat të ngrihen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe më pas të dërgohen në laboratorë (kufoma, karremi ose të vjella). Shumica e pesticideve të përdorura si helm degradohen shpejt.

Kufoma ose pjesët e kufomës të paketuara dërgohen për autopsi dhe ekzaminim toksikologjik në **Fakultetin e Mjekësisë Veterinare – Shkup.**



Karremat me helm dhe/ose gjurmët dhe mostrat mbliidhen dhe dërgohen për ekzaminim në **Njësinë për Hetimit Ligjor** pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Gjurmët dhe mostrat



Rregullat bazë për paketimin, etiketimin dhe shpërndarjen laboratorike të gjurmëve dhe provave

- Trajtoni mostrat vetëm nëse është e nevojshme dhe nëse jeni të kualifikuar për ta bërë këtë. Nuk trajtohet nga kurioziteti, veçanërisht kur bëhet fjalë për substanca helmuese ose toksike.
- Të shmanget çdo mundësi e kontaminimit të mostrave. Mostrat duhet të mbliidhen individualisht dhe nuk duhet të përzihen me njëra-tjetrën. Kur trajtoni karremat me helm, rekomandohet të përdorni dy palë doreza. Dorezat që keni përdorur kur keni ngritur karremin hiqen menjëherë për të parandaluar kontaminimin.
- I gjithë trupi duhet të hiqet dhe të dërgohet për ekzaminim. Nëse kjo nuk është e mundur, autopsia kryhet nga një mjek veterinar me përvojë në punën me kafshët e egra, dhe më pas duhet të kontaktohet një laborator për të vendosur se cilat mostra të trupit duhet të hiqen dhe të dërgohen për ekzaminim. Për të hequr kafshën e ngordhur, zyrtarët nga grupi i inspektimit mund të kërkojnë ndihmë nga shërbimi komunal lokal.
- Provat e gjetura paketohen veçmas, dhe shënohen në mënyrë përkatëse sipas shenjave të shënuara në procesverbal, në raport me vendin ku janë gjetur në vendngjarje. Nëse ka një numër të madh bishta cigaresh, secila paketohet veçmas. Provat që do t'u nënshtrohen analizave të ADN-së dhe shenjave të gishtërinjve duhet të mbahen në një vend të thatë, pa ekspozim në diell.
- Është e rëndësishme të theksohet se nëse nuk ka karrem pranë kufomës, duhet të merret në konsideratë dhe të analizohet mjedisi më i gjerë.

Masa të sigurisë

Gjatë trajtimit të gjurmëve, veçanërisht në prani të substancave të rrezikshme dhe viktimave të helmimit, është e nevojshme që të gjithë operativët dhe ata që janë të pranishëm në terren të kenë pajisjet e mëposhtme:

- **Doreza nitrile** (të ndërrohen me çdo trajtim të veçantë të gjurmëve dhe mostrave për të shmangur kontaminimin e tërthortë. Substancat toksike mund të absorbohen nëpërmjet lëkurës);
- **Maska FFP3** (maska FFP2 është e mirë, por nuk mbron nga helmi ose grimcat e tjera të imëta të substancave pluhur);
- **Mbulesa për këpucë;**
- **Kapelë për flokë;**
- **Kostum mbrojtës për gjithë trupin** (nëse përfshihen doza të larta helmi).

Procedurat e përgjithshme për marrjen e mostrave

- **Karrema me helm** – mbështillini në fletë të veçanta alumini dhe vendosini në një qese plastike të mbyllur ose kavanoz. Për më tepër, për të lejuar qarkullimin e ajrit, mund t'i mbështillni ato në qese letre. Shmangni fletët plastike, veçanërisht nëse vëreni helme në pjesën e jashtme të karremit. Ngrini karremin dhe/ose ruani në një dhomë të freskët.
- **Substancat helmuese** – një pjesë dërgohet në laborator për ekzaminim në kavanoza të mbyllura fort.
- **Kafsha e ngordhur (viktima)** – ruhet në një paketim të dyfishtë për të shmangur rrjedhjet aksidentale për shkak të dekompozimit. Dërgohet për ekzaminim sa më shpejt të jetë e mundur, ose nëse kjo nuk është e mundur, ngrihet dhe/ose ruhet në një dhomë të ftohtë.
- **Karrem ose të vjella në gojën e viktimës** – ruhen veçmas në letër alumini dhe më pas në një kavanoz të mbyllur.
- **Dheu** – materiali ruhet në një kavanoz të mbyllur. Nëse ka një shtresë dekompozimi nën trupin e kafshës, rekomandohet të mblidhen mostra deri në 5 cm nën trupin e kafshës.
- **Entomofauna** – i gjithë entomofauna ose një mostër e saj mblidhet në shishe dhe/ose enë me alkool (shih më poshtë).
- **Të vjellat** – si karremi edhe të vjellat duhet të ngrihen para se të dërgohen në një laborator ose të mbahen në vend të ftohtë.
- **Gëzofi, puplat, flokët** – ruhen në zarfe letre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për gëzofin, pasi elektriciteti statik i qeseve plastike mund të ndryshojë strukturën molekulare të ADN-së.
- **Mostrat e gjakut** – gjaku mblidhet me një shtupë, e cila, pasi të thahet, ruhet në një kuti plastike (rekomandohen shtupa me desikant/përthithës që lejojnë tharjen e shpejtë).
- **Bishtat e cigareve** – mblidhen dhe ruhen në qese letre të mbyllura. Të shmangen qeset plastike (për shkak të shfaqjes së mundshme të lagështisë).
- **Kanoçet, paketimet e cigareve, mbështjellësit, kontejnerët ose kavanozët me helm** – ngrihen për pjesët anësore dhe ruhen në një qese të mbyllur ose kavanoz.



Identifikimi i një kafshe të helmuar

Helmet që përdoren shpesh vrasin në mënyrë të ngjashme. Helmet mund të jenë komponime organofosforike dhe komponimet e karbamatit që pengojnë enzimën kolinesterazë, e cila rregullon sistemin nervor në trup. Me inhibimin e kësaj enzime, transmetimi i impulseve nervore ngadalësohet ose çaktivizohet dhe trupi përjeton një lloj "qarku të shkurtër". Prandaj, simptomat e zakonshme janë konvulsione, dridhje, ethe, të shoqëruara me të vjella, diarree dhe gjakderdhje të jashtme/të brendshme. Nëse konsumohet një dozë më e lartë dhe vdekjeprurëse, mund të rezultojë në sulm në zemër të kafsha (Fajardo et al., 2022).

Pozicioni i kufomës mund të jetë tregues, pasi na jep informacion në lidhje me momentet e fundit të jetës së kafshës, veçanërisht nëse e dimë se kufoma nuk është lëvizur. Pozicioni fillestar i trupit duhet të dokumentohet në detaje, pasi pas dorëzimit në laborator mund të ndryshohet dhe kështu humbet informacioni kritik për shkakun e vdekjes.

Shenjat e helmimit të gjitarët:

- Gjaku përmes hapjeve natyrore të trupit, të tilla si anusi, hunda dhe goja;
- Rritja e salivacionit, përkatësisht rritja e sekretimit të gjëndrave të pështymës;
- Piloerektura ose rrëqethja, veçanërisht në pjesën e shpinës ose në bisht. Kjo ndodh për shkak të hiperstimulimit të mbaresave nervore nga konvulsionet.



Përfaqësuesit e familjes së qenve (Canidae) kanë gojë të gjatë, nofull të gjerë të hapur, gjuhë të madhe dhe muskuj të forta të buzëve. Ata përjetojnë konvulsione nën ndikimin e helmit të konsumuar (Fajardo et al., 2022). Gjuha e nxjerrë mund të sugjerojë helmim.



Gjatë helmimit të maceve (Felidae), gjuha dhe kthetrat mund të dalin jashtë, gëzofi ngrihet përpjetë dhe mund të vërehen kontraktime në muskuj më të vegjël. Gjitarët e ngordhur zakonisht shtrihen anash.



Shenjat e helmimit te zogjtë:

- Krahët e shpendëve janë muskulozë dhe mund të vërehen konvulsione. Te shpendët më të mëdhenj (p.sh., shkaba), konvulsionet janë më pak të dukshme. Nëse krahët janë të hapur ndërsa bishti i drejtë, ka të ngjarë të bëhet fjalë për helmim.
- Pozicioni i kufomës në zogjtë grabitqarë është në formën e një ftohësi ndërsa krahët janë tërësisht të hapur.



- Shpendi ka pupla të ngurtësuar rreth sqepit të tij si rezultat i jargëzimit.
- Meqenëse shpendët kanë mekanizma të ndryshëm të koagulimit të gjakut në krahasim me gjitarët, plagët shërohen më shpejt, duke zvogëluar kështu rrezikun e gjakderdhjes deri në vdekje.
- Shpendi ka kthetra të mbyllura, me këmbë të kthyer përpara. Përrjashtim bëjnë shkabat me kokë të bardhë, kthetrat e të cilave nuk mbyllen plotësisht (ato nuk gjuajnë), dhe për këtë arsye nuk kanë muskuj të fortë dhe pas helmimit krahët zakonisht nuk u mbyllen (Fajardo et al., 2022).



Përcaktimi i datës së vdekjes dhe aplikimi i entomologjisë mjeko-ligjore

Gjendja e kufomës mund të na japë indikacione për datën e vdekjes, por pas 72 orësh nga shfaqja e saj, përdorimi i **entomologjisë mjeko-ligjore** bëhet shumë më i rëndësishëm.

Entomologjia është shkenca që merret me studimin e insekteve, ndërsa entomologjia mjeko-ligjore zbaton njohuritë e fituara në kërkimet civile dhe policore (Slavevska-Stamenkovikj et al, 2021). Ka disa arsye për aplikimin e entomologjisë mjeko-ligjore, të tilla si përcaktimi i kohës së vdekjes, nëse kufoma është zhvendosur nga një vend në tjetrin, nëse ka pasur manipulime shtesë në të, për zbulimin e plagëve ekzistuese, si dhe për zbulimin e pranisë së helmeve në organe.



Cilat janë aspektet më të rëndësishme që duhet të analizohen:

- **Biologjia e zhvillimit të specieve të insekteve nekrofagë** dhe fazat e larvave dhe faza e pupës;
- **Përbërja e përgjithshme e entomofaunës** që është e pranishme në fazat më të avancuara të kalbjes.

Gjurmet entomologjike duhet të merren nga një entomolog mjeko-ligjor, por në realitet kjo ndodh rrallë. Në atë rast, tekniku kriminalistik nga Ministria e Punëve të Brendshme duhet të mbledhë atë që është e nevojshme, por natyrisht që personi duhet të edukohet për mënyrën e duhur të ngritjes dhe paketimit të gjurmëve entomologjike.



Karrem helmues



Karrem helmues është shpesh një copë ushqimi me pluhur me një substancë toksike, zakonisht një produkt fitosanitar, siç është insekticid, rodenticid, fungicid, herbicid ose moluscid. Në Maqedoninë e Veriut, substancat më të zakonshme që përdoren si helm janë metomili (lanati) dhe kreozani. Shitja e këtyre substancave është e ndaluar në vendin tonë. Helmi mund të jetë vendosur në mënyrë të dukshme në pjesën e jashtme të ushqimit ose mund të jetë vendosur në ushqim, ku është fshehur plotësisht. Duke pasur parasysh që karremat me helm janë të ekspozuar ndaj kushteve të jashtme, ka të ngjarë që, pasi të fillojë hetimi, helmi tashmë është dekompozuar. Këto komponime mund të dekompozohen relativisht shpejt dhe lehtë dhe të avullojnë

në diell, ndonjëherë në vetëm disa orë. Kështu, është veçanërisht e rëndësishme që nëse gjendet të vjella, ato dhe toka nën të, të mblidhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Mbetjet e karremit me helm mund të jenë gjithashtu në gojën e kafshëve. Edhe këto mbetje duhet të mblidhen si prova. Karremat me helm lejojnë zhvillimin e mikroorganizmave dhe janë të ndjeshëm ndaj kalbjes, tharjes dhe humbjes së vetive. Prandaj, me kalimin e kohës ato bëhen të papërdorshme. Gjatë mbledhjes së tyre, nevojitet një reagim i shpejtë nga ekipi operacional në mënyrë që të sigurohen gjurmë cilësore dhe prova për hetime të mëtejshme.



Viç i pluhurosor me lanat © Nenad Petrovski



Analiza e hollësishme e karremave me helm




Në hetimin fillestar të një vepre të tillë penale, bëhet një përshkrim i hollësishëm i helmit që është vendosur si karrem dhe/ose vetë karremit. Pas ekzaminimit të karremit, bëhet një përshkrim vizual i gjendjes fizike dhe ngjyrës së helmit (nëse është e dukshme).

Pritet që analizat e mëtejshme në laborator të japin informacionet e mëposhtme:

1. Sa sasi e helmit u gjet?
2. Statusi (ligjshmëria), emri i markës, përbërja, informacione për përdorimin e tij.
3. Rreziku dhe vdekshmëria e lëndës toksike në kafshën e zbuluar.
4. A është përqendrimi i helmit i mjaftueshëm për të vrarë kafshën?

Gjatë përgatitjes së raportit, rekomandohet të shkruhet emri komercial. Informacione mbi pesticidet e përdorura zakonisht mund të gjendet në faqen e mëposhtme të internetit <https://pubchem.ncbi.nlm.nih.gov/>.

Nëse në analizë specifikohen doza vdekjeprurëse për disa specie të mbrojtura, rekomandohet përdorimi i raporteve dhe studimeve të specieve të ngjashme si viktima (Fajardo et al., 2022).



Funksionet dhe procedurat e laboratorit mjeko-ligjor

Kryerja e analizave toksikologjike në kafshët e egra të helmua është një proces kompleks dhe rezultatet e rreme negative janë të mundshme. Megjithatë, kjo nuk duhet të dekurajojë operativët që kryejnë hetimin penal.

Disa substanca toksike kanë një efekt kaq të dëmshëm në neurotransmetuesit në sistemin nervor, saqë kafsha ngordh me karrem në gojë, pa shkuar kurrë kjo substancë në stomak. Për shkak të kësaj, te shpendët grabitqarë, nuk kryhen gjithmonë analiza toksikologjike e veshkave ose mëlçisë, sepse vdekja e tyre ndodh para se helmi të arrijë në ato organe.

Në Doracakun për hetime policore për vepra penale mjedisore (2022, f. 233–234), autorët theksojnë arsyet kryesore të mëposhtme për rezultate negative të rreme:

- Kafsha ka përbirë shumë pak karrem;
- Helmi është absorbuar shpejt nëpërmjet lëkurës, në sistemin e tretjes ose është thithur, dhe kështu vështirë mund të zbulohet;
- Kafsha ka vjellë menjëherë para se të ngordhte, duke e larguar helmin në të vjella;
- Helmi nuk ka shkaktuar ngordhjen, por është tretur brenda kafshës, duke lëshuar efektet e tij toksike dhe nuk është zbuluar. Rregulli i përgjithshëm është se sa më e gjatë të jetë periudha midis helmimit dhe ngordhjes, aq më e vështirë është të zbulohet helmi;
- Helmi është shpërbërë në kufomë për shkak të nxehtësisë dhe kolonizimit të insekteve të pranishme;
- Laboratori ka analizuar organet ose indet e gabuara;
- Laboratori ka përdorur metoda analitike joadekuate për gjendjen e dekompozuar të mostrës;
- Laboratori ka përdorur metoda analitike joadekuate për të zbuluar të gjitha helmet e mundshme;
- Operativët kanë mbledhur vetëm një pjesë të kufomave ose karremave në terren, dhe pikërisht ato kanë dhënë rezultate të rreme negative.

Për më tepër, kallëzimi penal duhet të paraqitet në Prokurorinë Publike kompetente, së bashku me materialin provues të mbledhur, duke përfshirë skicat, fotografitë, raportet për analiza, listat e veprimeve zyrtare të ndërmarra, procesverbalet zyrtare (nga policia dhe shërbimet kompetente të inspektimit), deklaratat dhe materialet e tjera që mund të përdoren në procedurë. Në bazë të kallëzimit penal dhe materialit të paraqitur, Prokuroria Publike mund të refuzojë më tej raportin ose të fillojë procedurat hetimore.

Rezultatet e procedurës para hetimore dhe analiza e tyre thelbësore e grupit operacional lejojnë që ajo të synojë një autor specifik, ndërsa PP-ja të kërkojë zbatimin e hapave shtesë hetimorë. Prokuroria Publike më tej zhvillon hetimin dhe mund:

- të paraqesë padi në gjykatën kompetente;
- të kërkojë plotësimin e hetimit;
- të deklarojë heqjen dorë nga ndjekja e mëtejshme penale.

Detyrimet e të gjithë personave që kanë qenë të përfshirë në procedurën para hetimore dhe hetimore nuk përfundojnë pasi Prokuroria Publike të ngrejë aktakuzë, kurse shërbimet e inspektimit, ekspertët, dëshmitarët, si dhe policia me uniformë mund të thirren për t'u marrë në pyetje gjatë seancës kryesore.

Hetimi i helmimit të kafshëve të egra nuk është aspak detyrë e lehtë, por nuk është e pamundur nëse operativët kanë durim, aftësi vëzhgimi, koordinim dhe këmbëngulje të jashtëzakonshme.



Referenca

- Fajardo, I., Zorrilla, I., Ruiz, A., Aniceto J.J., Fernández Verón, I., de la Bodega, D., & Antonio Alfaro, J. (2022). Police Investigation Manual of Offences against Biodiversity. Junta de Andalucía and SEO/BirdLife.
- Graham, K., Beckerman, A. P., & Thirgood, S. (2005). Human–predator–prey conflicts: ecological correlates, prey losses and patterns of management. *Biological conservation*, 122(2), 159-171.
- Howard, W. E. (1962). Means of improving the status of vertebrate pest control. *Transactions of the 27th North American Wildlife Conference*, 27: 139-150.
- Kalaxhiev, G., Lazhetti, G., Nedellkova, L., Denkovska, M., Trombeva, M., Vitlarov, T., Jankulovska, P., Kadiev, D. (2018). Koment mbi Ligjin për procedurë penale. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup: OSBE.
- Karamers, R., Vojçiq, K., & du Maine, M. (2015) Doracak për planifikim, mbikëqyrje inspektuese dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së (aquis) në mjedisin jetësor. Tuning Projekt i BE-së ENEA (Enforcing Environmental Acquis - Zbatimi i legjislacionit të BE-së në mjedisin jetësor), MK/10/1B/EN/01.
- Malish Sazdovska, M. (2013). Doracak për hetime te veprat penale ekologjike. Fakulteti i Sigurisë – Shkup.
- Márquez, C., Vargas, J. M., Villafuerte, R., & Fa, J. E. (2012). Understanding the propensity of wild predators to illegal poison baiting. *Animal Conservation*, 16(1), 118-129.
- Slavevska-Stamenkoviq, V., Klekovska, D., Hiniq, J. (2021). Entomologjia mjeko-ligjore. Skriptë e brendshme për studentët e biologjisë. Fakulteti i Shkencave të matematiko - natyrore, Instituti i Biologjisë – Shkup.
- Whittington, P. (2022) Flies know me by my face, Life in a Southern Forest. Available at: <https://southernforestlife.net/happenings/2021/8/10/flies-know-me-bymy-face> (Accessed: 26 May 2024).



Ky Doracak u zhvillua në kuadër të projektit rajonal BalkanDetox LIFE (LIFE19 CIE/NL/001016) dhe financohet nga Programi LIFE i Bashkimit Evropian dhe Fondacioni për ruajtjen e shkabave (VCF).

Shoqata ekologjike e maqedonase
Rruga Todor Skalovski nr. 9a
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut

+389 (0)2 2402 773
cel. +389 (0)78 371 175

mes.org.mk
contact@mes.org.mk

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.98:[343.232:599(497.7)(035)

351.765:[343.232:599(497.7)(035)

343.98:[343.232:349.6(497.7)(035)

351.765:[343.232:349.6(497.7)(035)

СТАРОВА, Арта

Прирачник за криминалистички истраги и инспекциски надзор при случаи на труење диви животни / Арта Старова = Doracak për hetime kriminalistike dhe mbikëqyrje inspektuese në rast e helmimit të kafshëve të egra / Arta Starova ; превод на албански јазик Вјоса Таипи. - Скопје : Македонско еколошко друштво ; Shoqata ekologjiike maqedonase : Shkup, 2025. - 26, 26 стр. : фотографии ; 220x138 мм

Насл. стр. на припечатениот текст: Doracak për hetime kriminalistike dhe mbikëqyrje inspektuese në rast e helmimit të kafshëve të egra. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивна насока. - Текст на мак. и алб. јазик

ISBN 978-9989-648-46-5

а) Диви животни -- Труење -- Криминалистичка истрага -- Македонија -- Прирачници б) Диви животни -- Труење -- Инспекциски надзор -- Македонија -- Прирачници

COBISS.MK-ID 66843909